



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL Anr.72/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesuese, Nenad Lazić dhe Adnan Konushevc i anëtarë, si dhe me pjesëmarrjen e zyrtarit të lart ligjor Kudret Hasani, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), për shkak të vendosjes së posterit në trafo të energjis elektrike të kandidatëve për anëtar të kuvendit komunal për Zgjedhjet Lokale 2017, në seancën e panelit të mbajtur me 28.09.2017, mori këtë:

V E N D I M

Pranohet si e bazuar ankesa e Institutit Demokratik të Kosovës (KDI), dhe subjektit politik Aleanca për Ardhmërin e Kosovës (AAK), i shqiptohet dënimi më gjorbë në vlerë prej 550.00 (pesëqind e pesëdhjet) euro, të cilën detyrohet ta paguaj në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga dita e pranimit të këtij vendimi **nën kërcënim të përmbarimit**.

A r s y e t i m

Me datën 26.09.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Instituti Demokratik i Kosovës (KDI) me të cilën pretendon se me datën 26.09.2017 në rrugën Enver Dobraj në Deçan monitoruesit e tyre kanë hasur poster të kandidatëve për këshilltar komunal nga AAK të ngjitur në hapsira publike publike dhe në trafo të energjis elektrike. Me këtë rast parashtruesi i ankesës thekson se është bërë shkelje e dispozitës së Nenit 33 paragrafi 1 pika b) i LZP-së. Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur fotografi të printuara lidhur me rastin në fjalë.

Në përgjigje në ankesë të datës 27.09.2017, subjekti politik AAK, thekson se shkeljet nuk janë bërë nga strukturat e AAK-së dhe se këto mun te jene bere nga qytetaret apo individ te pa identifikuar, andaj ne përgjigje ne ankese theksohet se AAK me te pranuar ankesën ka ndermar veprimet e nevojshme duke e larguar posterin nga vendi ku ka qene i vendosur ai. Si dëshmi ka bashkangjitur fotografimin me të cilat shihet se është larguar posterit reklamuese nga vendi ku kanë qenë i vendosur.

Paneli, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

Ankesa është e bazuar

Nga fotografitë e ofruara si provë e cila gjendet në shkresat e lëndës shihet qartë se posteri reklamues i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga radhët e subjektit politik AAK është vendosur në trafo të energjis elektrike, veprime këto që janë në kundërshtim me nenin 33 pika b) të LZP-së e cila përcakton: *“Veprimet e ndaluara nga ana e subjekteve politike gjatë fushatës zgjedhore që ndalon vendosjen e pllakateve, posterave dhe njoftimeve në hapsira apo në rrugë publike.*

Duke u nisur nga arsyet e theksuara me lartë, Paneli konstaton se nga provat e ofruara shihet qartë se nga ana e subjektit politik AAK, është shkelur neni 33 pika (b) të LZP-së, pasi që posteri reklamues i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti politik AAK, është vendosur në objekt publik.

Paneli me rastin e vendosjes se gjobës, ka marrë parasysh rrethanat si në vijim:

- Natyra e shkeljes dhe ndikimit të mundshëm të saj në procesin zgjedhor;
- Shkallën dhe peshën e shkeljes;
- Nëse subjekti politik ka marrë pjesë në zgjedhjet e mëparshme, konsiderohet se kanë qenë të njoftuar me obligimet dhe përgjegjësit gjatë procesit të fushatës;
- Nëse subjekti politik ka bërë shkelje të ligjeve zgjedhore në fuqi në këto zgjedhje apo në zgjedhjet e mëparshme në Kosovë si dhe
- Shumën e fondeve të marra nga subjekti politik prej Buxhetit të Republikës së Kosovës, për zhvillimin e aktiviteteve të lidhura më fushatën zgjedhore.

Paneli, mori parasysh të gjitha rrethanat në rastin konkret ngase subjekti politik AAK, ka marrë pjesë edhe në zgjedhjet e kaluara që do të thotë se janë të njoftuar me rregullat zgjedhore, dhe se përkundër këtij fakti posteri reklamues i kandidatit për anëtar të kuvendit komunal nga subjekti politik AAK është vendosur në objekt dhe në hapsirë publike. Poashtu si rrethanë Paneli mori edhe faktin se subjektit politik në fjalë i dha mundësinë për tu përgjigjur ashtu që në përgjigjen e pranuar nga ana e tyre shihet qartë se brenda afatit të caktuar kanë ndërmar veprime për të bërë përmisimin e shkeljes ashtu që kanë tërhequr posterin nga vendi i palejuar ku ka qenë i vendosur ai, i cili veprim ka ndikuar në lartësinë e gjobës së shqiptuar në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli në kuptim të nenit 120.1 pika c) dhe nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

ZL. Anr.72/2017 më datën 28.09.2017.



Kryesuese e Panelit
Gyltene Sylejmani

Gyltene Sylejmani

Këshillë juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118.4 të LZP-së.